



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Junikut

Opština Junik - Municipality of Junik



KONTRATA

Titulli i tenderit: Marrja në shfrytëzim e paisjeve për spërkatje të duarve me dezinfektant

Numri i prokurimit: 636-20-5921-2-3-6

Numri i brendshëm: 636-20-025-236

Data: 11.11.2020

Komuna e Junikut (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), e përfaqësuar nga U.D. Zyrtaria Përgjegjëse e Prokurimit, Florinda Kukalaj në njërën anë,

dhe **N.SH. Alb Consulting**, (në vazhdim "Kontraktuesi"), me numër të regjistrimit të biznesit 811134824 dhe me numër fiskal 600614847, me adresë 50010, Gjakovë, me numër kontaktues: 044-266-192 dhe email: valonhaxhishabani154@gmail.com e përfaqësuar nga Valon Haxhishabani në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

Numri i prokurimit	636	2	0	5	9	2	1	2	3	6
Numri i brendshëm	636		2	0	0	2	5	2	3	6

Neni 1 Lënda

Lënda e kontratës do të jetë: Marrja në shfrytëzim e paisjeve për spërkatje të duarve me dezinfektant

1.1 Kontrata hynë në fuqi me 11.11.2020 dhe përfundon me 11.11.2021.

1.2 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 12 muaj nga data e marrjes së urdhëresës.

1.3 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë:

Administrata e Komunës së Junikut, objekti i QKMF- së, objekti i shkollës fillore "Edmond Hoxha", objekti i shkollës së mesme "Kuvendi i Junikut", objekti i Qendrës për Punë Sociale dhe objekti i Zjarrëfikësave.

1.4 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: 3,240.00€; Tremijë e dyqind e katërdhjetë euro e zero cent.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimi të tërë dërgesës.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimi të shërbimeve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Pejë, Dega- Deçan në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik- N.SH. Alb Consulting

Për Autoritetin Kontraktues- Komuna Junik

Emri:	Valon Haxhishabani	Emri:	Florinda Kukalaj
Pozita:	Drejtor	Pozita:	U.D. Zyrtare Përgjegjëse e Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	11.11.2020	Data:	11.11.2020
Vula:		Vula:	



Paramasa për aktivitetin e prokurimit me titull: Marrja në shfrytëzim e paisjeve për spërkatje të duarve me dezinfektant

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia për një shërbim	Nr. i shërbimeve për një vit	Çmimi njësi me TVSH për një muaj	Shuma me TVSH për 12 muaj
1	Shfrytëzimi mujor i spërktësit me sensor për dezinfektimin e duarve dhe mbushja permanente e paisjes me dezinfektant	copë	6.00	45.00	270.00	3,240.00
TOTALI I PERGJITHSHEM ME TVSH PER 12 MUAJ						3,240.00€

Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Specifikat teknike të pajisjeve dhe dezinfektantit:

Specifikacionit teknik i paisjes spërkatëse:

- Spërkatës me sensor për dezinfektimin e duarve
- Kapaciteti: 1000ml
- Materiali: abs
- Doza: 0.8-3ml me tre zgjedhje të rregullueshme: Gell, Alkohol edhe sapun i lëngshëm.
- Distanca e reagimit të sensorit: 10 ± 3 cm
- Furnizimi: Bateri të dimensionit C 4 x 1.5V
- Spërkatësi duhet të përfordhet në mbajtësin nga konstrukcioni, konstrukcioni të jetë llamarine dhe profil i hekur
- Mbajtësi duhet të jetë i ilustruar me udhëzuesin e përdorimit dhe të ketë logon e AK
- Dimensionet e mbajtësit:
 - Lartësia : 165cm
 - Gjerësia 40cm
 - Bazamenti 60 x 40 cm

Perberja fizike dhe kimike e dezinfektantit të lëngshëm:

Parametri	Njesia matese	Rezultati	Vlera e deklaruar	Metoda
Tretshmeria e ujit	/	I perfunduar	/	/
ph	/	5.5	5.5-6.0	Bazuar ne manualin HANNA 98127
Dendshmeria	g/cm3	0.8	0.786-0.8	Metoda e Piknometrit Gravimetrik
Mbetje totale e thate	%	2.50	/	Metoda Gravimetrike

PERBERJA/INFORMATAT E PERBERESVE:

Emri kimik	CAS - Numri	EC - Numri	Koncentrimi %
Uji	7789-20-0	231-791-2	30.00%
2-Propanol	67-63-0	200-661-7	48.10%
1-Propanol	71-23-8	200-746-9	21.90%

Operatori Ekonomik i pranon specifikimet e ANEKSIT 1 duke i nënshkruar dhe vulosur si në vijim:

Emri i Operatorit Ekonomik: ALB CONSULTING _____

Nënshkrimi: _____

Vula: _____





FRESH-C.O. SH.P.K.
RRUZHDI HAXHIJAJ N.N.
30000, PEJE. XK.

Tel: 00383 38 720 200
info@fresh-co.net
www.fresh-co.net

Ubn: 810081232
Vat.no.: 330375792

DEKLARATË KONFORMITETI

Deklarojm se produkti **Frecosal Ultra Dezinfektues për duar solucion**:

Në qoftë se përdoret konform udhëzimeve të pershkruara ne paketimin e produktit, ai është i lejuar për përdorim human, është efektiv për mbrojtje nga virusi i COVID-19 dhe nuk është i dëmshëm apo helmues për njerëzit apo fëmijët.

Deklarojm se produkti si me posht ka përmbajtjen e deklaruar si në këtë tekst ashtu edhe në tiketen e produktit në fjalë:

Produkti:

Frecosal Ultra Dezinfektues për duar Solucion

Përmbajtja e produktit:

Emri Kimik	CAS- Nr	EC-Nr	Koncentrimi %
Aqua	7789-20-0	231-791-2	30.00%
2-Propanol	67-63-0	200-661-7	48.10 %
1-Propanol	71 -23-8	200 -746-9	21.90 %

Përmbajtja Fiziko Kimike:

Parametri	Measure units	Result	Declared values	Method
Solubiliteti në ujë	/	Produkti i kompletuar	/	/
pH	/	5.5	5.5-6.0	Sipas Manualit HANNA98127
Densiteti	g/cm3	0.8	0.786-0.8	Metoda Gravimetrike me piknometer
Mbetje totale thate	%	2.50	/	Metoda Gravimetrike

Kjo deklaratë është valide vetëm për tenderin me titull: "Marrja në shfrytëzim e paisjeve për spërkatje të duarve me dezinfektant " me numër prokurimit: 636-20-5921-2-3-6



02/10/2020

Date